



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
SUHAREKË



PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027

KOMUNA E SUHAREKËS

1	<i>Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave</i>	6
1.1	Qëllimi dhe fushëveprimi i planit	6
1.2	Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit	6
1.1.	Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave	7
1.3	Konteksti lokal	10
2	<i>Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave</i>	21
2.2	Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.....	21
2.3	Rishikimi i implementimit të planit	23
2.4	Performance e shërbimit	26
2.5	Performanca financiare e MM	27
2.6	Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave.....	28
2.7	Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave	28
3	<i>Objektivat e MM dhe plani operacional</i>	30
3.1	Vizioni i MM.....	30
3.2	Objektivat dhe caqet e MM	30
3.3	Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave	30
3.4	Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave.....	33
3.5	Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM	41
3.6	Objektivi nr. 4: Eliminimi i deponive ilegale.....	44
3.7	Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave	45
4	<i>Plani i MM në kushte emergjente</i>	47
5	<i>Plani financiar, veprimit dhe i monitorimit</i>	48

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IWMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KfW	Kreditanstalt für Eiederaufbau
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publik privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Popullsia e Komunës së Suharekës
Tabela 3	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 4	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 5	Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës
Tabela 6	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 7	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 8	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 9	Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 10	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 11	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 12	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 13	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 14	Shpenzimet e sistemit të MM
Tabela 15	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 16	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 17	Lista e objektivave të planit
Tabela 18	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 19	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 20	Parashikimet demografike të populates
Tabela 21	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 22	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 23	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 24	Orari I ndarjes së mbeturinave në burim
Tabela 25	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 26	Strategjia e zgjerimit më shërbim
Tabela 27	Efikasiteti i stafit
Tabela 28	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 29	Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela 30	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit – Objektiv 1, Parandalimi dhe reduktimi
Tabela 31	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 2 Ripërdorimi dhe riciklimi
Tabela 32	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 3 Ofrimi i shërbimeve cilësore
Tabela 33	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 4 Deponimi i sigurtë
Tabela 34	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 5 Zhvillimi i kapaciteteve

Fjala e kryetarit

Qytetarë të komunës së Suharekës, ne si administratë komunale jemi zotuar që të menaxhojmë mbeturinat në mënyrë të qëndrueshme. Rishikimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave e konfirmon zotimin tonë në këtë fushë. Nëpërmes këtij plani komuna e Suharekës do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të investuar në mënyrë të planifikuar në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunë. Planifikimi i tillë do të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave, ruajtjen e shëndetit publik dhe përfundimisht do të ndikojë edhe në gjendjen mjedisore në komunën tonë. Duke e rregulluar sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunë, ne gjithashtu synojmë që të krijojmë kushte edhe për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmes veprimeve për ndarje dhe reciklim të mbeturinave.

Në fund, ne si administratë komunale jemi duke bërë përpjektet për të krijuar një ambient sa më të pastër për qytetarët tanë, mirëpo kjo mund të arrihet vetëm në bashkepunim të plotë të të gjithë akterëve në komunë.

Në emër të qytetarëve të Komunës së Suharekës, falënderoj kontributdhënësit gjatë hartimit përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent gjatë hartimit të dokumentit, në kemi arritur një konsensus të gjerë nga banorët dhe ekspertët e fushave të ndryshme. Një qasje e tillë ka bërë që në Plan të përfshihen interesat dhe specifikat e të gjitha grupeve të shoqërisë në Komunë që është një bazë e mirë që zbatimi i tij të ketë një përkrahje të gjerë nga të gjitha palët e interesit. Komuna ka mirëpritur angazhimin e të gjithë akterëve që kanë marrë pjesë në këtë proces, të cilët përmes të dhënave, vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të tyre kanë përmirësuar Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, 2023-2027 në komunën e Suharekës, në veqanti GIZ-in që ka mbështet revidimin e këtij plani, KIWER, CEDE dhe ekipin mbështetës teknik që këtë dokument strategjik ta konceptojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës me një mjedis të pastër për të gjithë qytetarët e komunës së Suharekës.

Singerisht,
Bali Muharremi
Kryetar i Komunës së Suharekës

1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Suharekës është dokument planifikimi për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe përmbushjen e objektivave të strategjisë. Përmes PKMM-së, komuna mundëson një qasje të menaxhimit të integruar të mbeturinave, duke zbatuar një sërë masash, ku synimi kryesor është reduktimi i mbeturinave komunale që gjenerohen në burim, ngritja dhe zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave, aspektet financiare të sistemit, aspekte tjera siç janë monitorimi i gjendjes në këtë sektor, bashkëpunimi me të gjithë akterët, ndërgjegjësimi i popullatës etj. PLMM përfshin:

- Përcaktimin e prioriteteve të sektorit me qëllim përmbushjen dhe përafrimin me objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (SMIM) 2021-2030 dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturinave (PVMIM) 2021-2023; përkatësisht ndërmarrjen e veprimeve konkrete në realizimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara;
- Vlerësimin e sistemit aktual të mbledhjes së mbeturinave, pajisjeve dhe personelit, duke e përkufizuar bazën e shërbimeve dhe aktiviteteve aktuale për menaxhimin e mbeturinave,
- Rregullimin e aspekteve organizative dhe operacionale në nivel të komunës në bashkëpunim me akterët tjerë të përfshirë në menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Rolin dhe përgjegjësitë institucionale dhe rregullativen funksionale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave;
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të kuadrit, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimin të gjendjes në këtë sektor, rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes etj.;
- Rregullimet financiare, duke pasqyruar nevojat financiare me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit të mbeturinave, si dhe analizimin e burimeve financiare për investime në sektor.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe vepruese për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e projekteve, buxheteve dhe planeve investuese, si dhe tërheqjen e mbështetjes financiare dhe profesionale.

1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit

Baza ligjore për hartimin e PKMM-së, është përcaktuar në Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili rregullon aspektet e menaxhimit të mbeturinave. LM ofron rregullimet bazë mbi MM, duke përfshirë klasifikimin e mbeturinave, rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq në menaxhimin e mbeturinave, si dhe aspektet tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe standardet e operimit, licencimit të operatorëve për MM etj.

1.2.1 Korniza ligjore për MM

Aspekti ligjor në Republikën e Kosovës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave përbëhet nga kjo kornizë ligjore me specifikimet përkatëse:

Ligji nr. 04/I-060 “Për Menaxhimin e Mbeturinave”, 2012 – ky ligj, i cili paraqet bazën ligjore për përcaktimin e kompetencave komunale në Republikën e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave. Sipas këtij ligji komunat duhet të: i) hartojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional; ii) të zbatojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave; iii) përcaktimin e taksës dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale; iv) sipas ligjit dy ose më shumë komuna mund të bashkëpunojnë për menaxhimin e mbeturinave.

Sipas ligjit këto plane komunale duhet të fokusohen kryesisht tek: 1) skemat/ programi për mbledhjen e mbeturinave; 2) propozimet për teknikat e duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave; 3) programin për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave; 4) vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji përcakton që plani komunal hartohet për një periudhë 5 vjeçare dhe do të adresojë kapacitetet ekzistuese dhe ato në të ardhmen për mbledhjen e mbeturinave, trajtimin dhe deponimin e tyre, ku do të përcaktohet edhe nevoja për veprim për shërbimin cilësor ndaj qytetarëve, si dhe draftimin e një rregullore komunale të menaxhimit të mbeturinave

Gjithashtu sipas këtij ligji, menaxhimi i mbeturinave komunale nga komunat duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një ose më shumë operator publik ose privat të licencuara për administrimin e mbeturinave.

Ligji nr. 04/I-111 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të ndërmarrjeve publike”, 2012

– Sipas këtij ligji Komunat kanë të drejtë të krijojnë ndërmarrje publike komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji nr. 04/I-045 “Për partneritetin publiko-privat – dispozitat e këtij ligji rregullojnë ofrimin e shërbimeve publike dhe /ose infrastrukturën publike për menaxhimin e mbeturinave, ku përfshihet mbledhja, grumbullimit, trajtimi dhe riciklimi i tyre.

1.1.Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të

menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunat e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunat nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e

mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- **Agjencioni i Vetrinës dhe Ushqimit** - është përgjegjës për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP)**- është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale. DSHP është përgjegjëse edhe për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- **Drejtoria e Financave** - është përgjegjës për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** - ndër të tjera është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësiror dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës, po ashtu siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

- **Drejtoria për Punë Inspektuese** - është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- **Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen “Pastërtia”** -ushtron mbikëqyrje të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të KRM “Pastërtia”. Komisioni ka autoritet edhe të shkarkoj Bordin e Drejtorëve në rast të përformancës jo të mirë.
- **Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes KRM “Pastërtia”**- ushtron mbikqyrje direkte të veprimtarisë menaxhuese dhe operative të KRM “Pastërtia” dhe ka autoritet të shkarkojë dhe emërojë stafin menaxhues të ndërmarrjes.


1.3 Konteksti lokal

Pozita gjeografike:

Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpçës. Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 42°15' dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore Jezercit, Guri i Dellocit (lindje). Kjo komunë ka një sipërfaqe prej 362 km². Shumë rrugë të rëndësishme kryqëzohen në sipërfaqen e komunës, duke e lidhur atë me kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, me qendrën rajonale të Prizrenit dhe më tutje me Shqipërinë. Komuna e Suharekës i përket rajonit të Prizrenit.

Lokaliteti i Suharekës daton nga parahistoria-koha e neolitit. Dëshmi për këtë janë gërmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të komunës. Më karakteristike janë gërmadhat ende të pa hulumtuara në lokalitetin e quajtur Dybiqak. Lokaliteti i pasur arkeologjik është edhe vendi i quajtur Hisar. Gjatë luftërave të gjata kundër ilirëve, romakët shkatërruan shumë vendbanime ilire. Në këtë drejtim pësuan vendbanimet posaçërisht ato të fortifikuara, që ishin të njohura në atë kohë si dhe fortifikatat mbrojtëse të popullatës iliro-dardane siç është kështjella e Kastercit Gjatë periudhës së Mesjetës, vendbanimi i Suharekës (Theranda) ka shërbyer si ndalesë për Karvanet tregtare pasi që është e njohur nga burime të ndryshme se në Suharekë janë kryqëzuar dy rrugë të rëndësishme tregtare, rruga Egnatia që lidhte Durrësin me Kostandinopojën dhe rruga Lissus-Nissus (Lezhë-Nish). Në periudhën e re, për nga veprimtaria ushtarake, Suhareka është konsideruar, vend strategjik e njohur kjo nga Gryka e Carralevës si vend gjeostrategjik për mbrojtjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si Qendër Administrative e kohës dhe kryengritjeve të mëvonshme që quan deri në Pavarësinë e Shqipërisë. Me vendimet e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Suhareka si lokalitet mbetet nën sundimin e Serbisë. Kjo periudhë shënon një faqe të re të historisë së trevës sonë ngase represioni serb ishte shumë i theksuar me qëllim të spastrimit etnik dhe sllavizimit të kësaj treve edhe me masakra të mëdha si rasti i Nishorit i cili në atë kohë numëronte rreth 60 shtëpi, ku u rrënuar i tëri me topa dhe u ekzekutuan 42 burra dhe të rinj të këtij fshati. Periudha nga viti 1913–1918, njihet si periudha më e vështirë e kësaj treve ngase përveç pasojave të Luftës së Parë botërore njihet edhe si periudha e zisë së bukës e cila u shkaktua edhe si pasojë e luftës edhe si pasojë e thatësisë e njohur si Koha e Bugarit. Vitet 1919 -1939 represioni serb e aplikoi edhe një metodë të re e njohur si reforma agrare dhe kolonizimi i kësaj treve me kolonë serbo – malazet nga vise të ndryshme të mbretërisë serbo kroate sllovene duke shkaktuar edhe varfëri të skajshme të popullatës shqiptare e cila merrej kryesisht me bujqësi primitive dhe blegtori. Gjatë kësaj periudhe popullata shqiptare u orientua në kultivimin më të madh të vreshtarisë. Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimit nga nazifashtët italian dhe gjerman nga 1941- 1945 përveç pasojave që krijoj lufta e dytë botërore në historinë e trevës sonë është e njohur edhe si periudhë kur u hapën shkollat e para shqipe, e njohur si Koha e Italisë. Në periudhën pas Luftës së dytë botërore shkak i moszhvillimit të kësaj treve ishte Reforma agrare e zbatuar nga pushteti komunist serbosllav, e cila la pasojë të rënda për banorët e Suharekës duke shkatërruar bazën

ekonomike të familjeve të fuqishme shqiptare të cilësuar si kullak, sepse nuk përshtateshin me ideologjinë komuniste. Kthesë në aspektin e zhvillimit ekonomik, arsimor e kulturor, Komuna e Suharekës filloi ta ndiejë pas viteve të 60-ta deri në fund të viteve 80-ta të shekullit të kaluar kur filluan të zhvillohen disa veprimtari zejtare dhe tregtare, hoteliere dhe ndërtimi i shkollave për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin e obligueshëm dhe arsimin



Harta - Pozita gjeografike e komunës se Suharekës

Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1048m, në lindje me malet e Jezercit 1677m (Kryet e Ahishtës) dhe në juglindje me malet e Sharrit 2092m (Dera e Pashës) derisa në perëndim shtrihet rrafshina (ultësira) e Prizrenit. Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455m. Sipërfaqja e kësaj komune është 361.78km² (që mbulon 3.3 % të territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës (prej 36099ha) 15,074ha ose 41.7% janë të mbuluara me pyje, 19,373ha ose 53.7% janë tokë bujqësore dhe 1652ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër. Klima është kontinentale me ndikim mesdhetare, temperatura mesatare sillet rreth 11°C. Edhe pse territori i komunës është i mbuluar mirë me rrjetin e lumenjve (sipërfaqe ujore) sasia e ujit të lumenjve është e pamjaftueshme për ujitjen e tokave bujqësore.

Kushtet klimatike

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është 110C. Në muajin gusht lajmërohet maksimumi absolut prej 38.2 0C. Amplituda absolute është 52.3 0C. Komuna e Suharekës gjendet në jug të Kosovës dhe ka klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Në vijim janë radhitur vlerat kyçe klimatike:

- Vlerat mesatare relative vjetore e lagështisë në Suharekë është 74.3%. Lagështia më e ulët relative e ajrit në Suharekë është në muajin gusht 63.2%.
- Në Suharekë është vranësira më e vogël në muajin gusht (2.7), ndërsa vranësira mesatare vjetore është 5.0 të dhjetat e qiellit.
- Vlera mesatare e të reshurave në Suharekë është 674.0 mm. Të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në muajin shkurt dhe janar.
- Të reshurat më të mëdha në Suharekë janë gjatë muajit mars 169.6 mm, ndërsa sasia minimale e të reshurave në këtë territor është 410.0 mm.
- Në Suharekë më së shpeshti fyejnë erërat nga verilindja (193%), lindja (32%), dhe jugperëndimi (32%), ndërsa më së paku fyejnë erërat nga jugu (33%), dhe veriperëndimi (13%). Shpejtësinë mesatare më të madhe e kanë erërat nga jugperëndimi (4.6m/sek) dhe verilindja (3.6m/sek).

Hidrografia

Rrjeti hidrografik që kalon nëpër territorin e komunës karakterizohet me lumenj të vegjël me tipare karakteristike për përroskat malore apo lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisave të ujit gjatë vitit. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka pak ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale. Të gjithë ujërat burojnë dhe rrjedhin në territorin e komunës përpos disa përroskave si përroska e Carralevës, Topillës dhe lumit të Bllacës që burimin e kanë në territorin e komunës së Suharekës kurse pjesa më madhe e tyre vazhdojnë rrjedhën dhe derdhen në territorin e komunave tjera ha ose 4.6%. numër të madh të lumenjve . Harta 6 Shtrirja hidrogeologjike Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është Lumi Toplluha. Ky lum formohet nga rrjedhat e burimeve të ujit duke filluar nga Qafa e Duhlës e deri në Malet e Budakovës dhe përroskat lokale duke e formuar Lumin e Suharekës dhe si degë e burimeve të ujit nga Pagarusha dhe Nishori (Lumi i 24 Semetishtit). Toplluha është një ndër degët e majta të lumit (më të madh në Kosovë) Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Toplluhës është F=510.0 Pellgu i Lumit km², kurse gjatësia e lumit është 15.5 km . të Sopisë formohet nga Lumi i Vraniqit nga burimet e ujit nga bjeshka e Jezercit dhe dega tjetër nga Lumi i Zi që formohet nga pellgjet e ujë rave me rrjedhë nga gryka e Dellocit dhe Lumit Maqiteva. Pellgu i Lumit të Sopisë bashkohet me lumin Toplluha në te rriturin e Komunës së Mamushës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi i Bardhë me burim nga Bjeshka e Mushtishtit me rrjedhë nën Sallagrazhdë dhe Gelancë, bashkohet me Lumin e Grejkocit nën fshatin Gelancë dhe vazhdon rrjedhën territorin e Komunës së Prizrenit duke u bashkuar me lumin Toplluha në fshatin Zojz dhe vazhdon rrjedhën e derdhjes në drejtim të Lumin Drin.

Resurset natyrore:

Pasuritë minerare, eksploatimi i tyre, fondi pyjor, fondi ujore, etj.

Komuna e Suharekës ka rrjet të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka një numër të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë nëpër territorin e komunës. Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore apo lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisave të ujit gjatë vitit. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka pak ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale. Të gjithë ujërat burojnë dhe rrjedhin në territorin e komunës përpos disa përroskave si përroska e Carralevës, Topillës dhe lumit të Bllacës që burimin e kanë në territorin e komunës së Suharekës kurse pjesa më madhe e tyre vazhdojnë rrjedhën dhe derdhen në territorin e komunave tjera.

Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është Lumi Toplluha. Ky lum formohet nga rrjedhat e burimeve të ujit duke filluar nga Qafa e Duhlës e deri në Malet e Budakovës dhe përroskat lokale duke formuar Lumin e Suharekës dhe si degë e burimeve të ujit nga Pagarusha dhe Nishori. Toplluha është një ndër degët e majta të lumit (më të madh në Kosovë) Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Toplluhës¹³ është $F=510.0\text{km}^2$, kurse gjatësia e lumit është 15.5km. Pellgu i Lumit të Sopsisë formohet nga Lumi i Vraniqit nga burimet e ujit nga bjeshka e Jezercit dhe dega tjetër nga Lumi i Zi që formohet nga pellgjet e ujërave me rrjedhë nga gryka e Dellocit dhe Lumit Maqiteva. Pellgu i Lumit të Sopsisë bashkohet me lumin Toplluha në territorin e Komunës së Mamushës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi i Bardhë me burim nga Bjeshka e Mushtishtit me rrjedhë nën Sallagrazhdë dhe Gelancë, bashkohet me Lumin e Grejkocit nën fshatin Gelancë dhe vazhdon rrjedhën territorin e Komunës së Prizrenit duke u bashkuar me lumin Toplluha në fshatin Zojz dhe vazhdon rrjedhën e derdhjes në drejtim të Lumin Dri. Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut të lumit Toplluha është tokë punuese, rreth 30% livadhe dhe kullosa, 10% male dhe pjesa tjetër është djerrinë.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në komunën e Suharekës është 36, 099 ha. Nga kjo sipërfaqe 19,377 ha (53.7%) - tokë bujqësore pjellore, 165 2ha (5%) - tokë jopjellore apo djerrinë si dhe 15,074 ha (42%) -pyje. Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, 12,666 ha është tokë e punueshme, 1652 ha të pa kultivuara dhe 2250 ha livadhe dhe kullosa. Kjo tokë është e mbjellë me kulturat bujqësore si drithëra, vreshta, perime dhe pemë. Pasuritë minerare, sa i përket pasurive minerare, komuna e Suharekes ka një numër të konsiderueshëm të kompanive që bëjnë eksploatimin dhe përpunimin e produkteve nga guri.

Popullsia

Tabela 1: Të dhënat mbi popullatën			
Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i popullatës	Numri i amvisërive	Numri i popullatës	Ngritje / zbritje %

59722	9145	56366	- 5.6
-------	------	-------	-------

Të dhënat le të i referohen të dhënave të regjistrimit të popullatës dhe të dhënave të fundit të vlerësimit. Të identifikohen trendet e migrimit sin ë pjesën urbane ashtu edhe rurale, diskrepancat me të dhënat zyrtare, etj.

Të ofrohen të dhëna edhe për popullatën jorezidente nëse ka në dispozicion!

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, numri i përgjithshëm i banorëve të komunës së Suharekës është 88,126 (me banoret jo rezident). Rreth 20 % (17, 625) e popullatës së komunës jeton në zonat urbane të komunës, ndërsa rreth 80 % (70, 501) jetojnë në zonat rurale të saj. Përderisa numri i përgjithshëm i amvisërive rezidente në komunën e Suharekës është 9194, një familje i ka mesatarisht 6.5 anëtarë.

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës rritja e vlerësuar e popullatës gjatë vitit 2014 ka qenë -483 banorë apo -0.79%. Shifra e zvogëlimit në fjalë përmban edhe elementet migratore të cilat kanë ndikuar në uljen e numrit te popullsisë ne komunën e Suharekës. Shtrirja e popullatës është afërsisht proporcionale në mes zonës urbane dhe asaj reale pra: 17, 625 banorë në zonën urbane (20.0%), si dhe banorë në zonën rurale 70, 501 (80.0%).

Tabela 2. Popullsia e Komunës së Suharekës¹

Popullsia	Total
Banore resident	59,708
Banor jo resident	28,418
Urbane	17,625
Para Urbane	1,765
Rurale	61,750
Rurale e thellë	6,986
Total	88,126

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshin Suharekën dhe këto 42 vendbanime: Bllacë, Budakovë, Bukosh, Breshanc, Delloc, Dobërdelan, Dragaqinë, Dubravë, Duhël, Dvoran, Greikoc, Greiçec, Gelancë, Gjinoc, Javor, Kastërc, Krushicë e Epërme, Krushicë e Poshtme, Leshan, Luzhnicë, Maqitevë, Mohlan, Mushtisht, Neprebisht, Nishor, Papaz, Peqan, Popolan, Qadrak, Reshtan, Reqan, Savrovë, Samadrexhë, Sallagrazhde, Semetisht, Sllapuzhan, Sopijë, Stravuçinë, Studençan, Tërrnje, Vërshec dhe Vraniç. Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2017, Komuna e Suharekës ka 41 vendbanime, ku jetojnë 88,1265, banorë në një sipërfaqe prej 361.78 km² me dendësi banimi prej 165 banorë/km².

Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Të jepen të dhënat e mjedisit dhe biodiversitetit, statusin e ujrave, florës faunës, ndotjes, ndikimit njerëzor, masat e ndërmarra për mbrojtje, etj.

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është problem mjaft serioz dhe është prezent pothuaj kudo. Po ashtu edhe në komunën e Suharekës kjo çështje është evidente. Ndotja më

¹ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2014, Agjencia e Statistikave të Kosovës: Numri i përgjithshëm i popullsisë

e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj. Gjithashtu hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në mes të Reshtanit dhe Neprebishtit në lum bëhet eksploatimi i rërës. Për shkak të nevojave për djegie por edhe për ekonomi pyjet dëmtohen pa kriter nga fshatarët.

Ajri

Edhe pse nuk monitorohet e nuk dihet se cilët përbërës ndotës të ajrit dhe sa janë prezent në të, ai është i ndotur në qendrën urbane. Kjo ndotje shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale si dhe komunikacioni (gazrat e liruar nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Koridori i autoudhës Morinë-Merdare që kalon në krah të qytetit e ka zvogëluar dukshëm lëvizjen e automjeteve që kalojnë brenda qytetit. Por në kohe festash dhe ngarkesave tjera në vere dhe dimër ende ka ngarkesë të theksuar të automjeteve, kjo edhe për shkak të mungesës së një rruge unazore që do të devijonte trafikun e automjeteve që kalojnë nëpër magjistralen kryesore që lidhë Prishtinën me Prizrenin. Duke marrë parasysh që në Suharekë nuk ka rrjet të ngrohjes qendrore, të gjitha njësitë e banimit ngrohen përmes burimeve alternative si drunj, thëngjill, naftë që kanë impakt në ndotje të ajrit.

Ujerat

Lidhur me ujin e pijes disa vendbanime kanë probleme sepse nuk kanë qasje në sistemin e ujësjellësit dhe ujin e pijes e marrin nga pusët individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësor (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës. Në komunën e Suharekës 40% e banorëve kanë qasje në ujësjellës dhe në sistemin e kanalizimit janë të kyçur 45% e banorëve.

Toka

Në këtë komunë toka është e ndotur nga prania e deponive ilegale të mbeturinave ku vetëm 43% e popullatës janë përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave. Mirëpo është duke u punuar në implementimin e projektit për eliminimin e deponive ilegale dhe transferimin e mbeturinave në deponinë regjionale të Prizrenit. Degradimi i tokës shkaktohet edhe nga prerja e pyjeve dhe funksionimi i gurëthyesve si dhe shfrytëzimi i inerteve në lumenj. Mbrojtja e mjedisit ndërlihet, me sektorin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore (37 objekte natyrore nën mbrojtje), zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe ka efekt pozitiv në to, ndërsa me sektorët tjerë është në konflikt e sidomos me atë të industrisë, sepse industria ka ndikim negativ në mjedis.

Flora

Sipërfaqet bujqesore - ekonomike janë sipërfaqe të punuara (23,378 ha), ku bujqësia është njëra ndër degët kryesore të veprimtarive ekonomike. Sipërfaqja e punuar, respektivisht arat dhe kopshtet (12,918 ha shfrytëzohen kryesisht për prodhimin e grunajav) e (grurit, misrit, elbit dhe thekrës), të bimëve industriale dhe perimeve (grosha, patatja, domatja, specat, sallata etj) dhe bimëve për kafshë (tërfoja dhe jonxha). Përmishtet përfshijnë sipërfaqen prej 426 ha . Përmëtaria nuk është një degë aq e zhvilluar eko nomike. Në to kryesisht kultivohen kumbullat, mollët dhe qershitë. Ndërkaq falë pozitës gjeografike, kualitetit të tokës dhe kushteve tjera shumë të mira për zhvillimin e vreshtarisë e që s ipas të dhënave nga “Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë” d eri në fund të vitin 2018 n Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 2,753 ha ë prodhimtari kanë qenë 513.84 ndërsa kullosat 5,578 ha

ha vreshta. . Sipërfaqet e pashfrytëzuara ekonomike janë pyjet dhe zabelet. Gjendja ekzistuese e pyjeve dhe e fondit të pyjeve edhe pse janë ndërmarrë masa me qëllim të kultivimit, kujdesit dhe zhvillimit të pyjeve, nuk janë aq të mira edhe pse kushtet janë të volitshme. Sipërfaqe pyjore përbëjnë 15,561 ha Suharekës shtrihen në la rtësi mbidetare 455 m prej tyre 1,600 deri 1760 m . ha janë pyje të larta. Pyjet e komunës së Këto pyje janë kryesisht pyje gjethore (lisi dhe ahu) ndërsa haloret janë mjaft të pranishme. Si lloje përcjellëse të pyjeve lisore janë: shegët, gorniçet, dardhat e egra, gështenja etj., ndërsa të kaçubave pyjore: murrizi, thana, trëndafili i egër, etj.

Fauna

Në ujërat e kësaj komune ekzistojnë këto lloje peshqish: krapoliq, brocak, mustak të përrojeve, dylmorë, por ka edhe ngjala. Në këto ujër a ka edhe gaforre, bretkosa dhe gjarpërinj të ujit. Nga kafshët shtëpiake kultivohen: gjedhët, delet, dhinë dhe shpezët. Në zhvillimin e blegtorisë ndikojnë përveç të tjerash pjesët e imta të sipërfaqeve të punuara dhe kullosat e pakta dhe të pa begatshme. Nëpër livadhe jetojnë stërqoka, sorra, thëllëza, shkurtëza, kukuva, lajmërohen edhe derrat, dhelprat, ujçit

Të dhënat mbi ekonominë lokale

Të jepen të dhënat për industrinë kryesore në komunë me theks të veçantë bujqësinë dhe turizmin, punësimin, aktivitetet e tyre. Të dhënat mbi sasinë e prodhimit eksportet, etj.

Zhvillimi Ekonomik në Komunën e Suharekës kryesisht bazohet në disa fusha të cilat janë me prioritet për zhvillimin e komunës dhe janë vlerësuar si mundësi e mirë për zhvillim në fusha si: Agrokulturë, Turizëm, Energji dhe Prodhim. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme karakterizohen me zhvillime të ndryshme të veprimtarive, ndërsa si ndërmarrje të mëdha janë Fabrika e Prodhimit të gomës "Ballkan", Fabrika e prodhimit të verës "AgroKosova Holding", Fabrika për përpunimin e lëkurës "Solid", Fabrika për tekstil "Arta-Text", Fabrika për përpunimin e produkteve të mishit "Flor-en", fabrika për përpunimin e pijeve freskuese joalkoolike "Frutex", dhe një sërë ndërmarrjesh për përpunimin e produkteve të drurit, plastikes, aluminit, metalit, etj. Një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik paraqesin Zona Industriale në Shirokë dhe Agro Zona në Samadrexhë.

Zona Industriale në Shirokë Zona Industriale është themeluar në vitin 2009, me një sipërfaqe prej 163 ha, me 78 parcela ndërtimore. Zona është e vendosur në afërsi të rrugës Prizren – Prishtinë, e cila është licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2017. Në bazë të projektit (PRrU) zona përbehet nga 12 tërësi,

Në Zonë Industriale aktualisht janë 53 biznese që kanë kontratë për shfrytëzim të parcelave siç janë: Kompania "SOLID" me-280 punëtor - prodhim i Këpucëve dhe përpunim të Lëkurës, "Graniti&CO Sh.p.k"- prodhim të stiropolit dhe llaqit fasadues, N.t.sh. "Stomatologjia"- prodhim i produkteve farmaceutike, "Seti Commerc" Sh.p.k.-prodhim i elementeve të betonit, Kompania Intertranscopy -prodhim i armaturës, Kompania "I Seferi" - prodhim i betonit dhe elementeve të tij, Dardania Eien prodhimi i verës, Vllesa Co prodhim i shportave të plastikes, si dhe shumë kompani të tjera që janë pjesë e kësaj zone. Sipas të dhënave të deri tanishme në Zonë Industriale janë të punësuar afërsisht 1000 punëtorë, po ashtu vlen të theksohet se veçanti e kësaj zone është edhe Shkolla e Mesme Profesionale "Abdyl Ramaj", ku në këtë shkollë përgatiten kuadro për tregun e punës, veçanërisht për bizneset që zhvillohen brenda Zonës.

Agrozona në Samadrexhë Agrozona është me sipërfaqe prej 35 ha, në ZK Samadrexhë ndodhet pranë rrugës Suharekë-Rahovec. Është themeluar me iniciativë të Komunës së Suharekës dhe Rahovecit. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian, për përkrahje të zhvillimit në regjionin ekonomik jugor të Kosovës për të krijuar ambient të përshtatshëm për biznes, rritje të aftësive ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ky projekt është kontribut i drejtpërdrejt dhe strategjik me objektivat e përgjithshme të Komisionit Evropian për të krijuar një bazë për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë. Sipas të dhënave të fundit, shfrytëzues të parcelave për 99 vite janë gjithsej 16 shfrytëzues (persona fizik dhe juridik).

Bujqësia

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në komunën e Suharekës është 36, 099ha. Nga kjo sipërfaqe 19,377ha (53.7%) - tokë bujqësore pjellore, 1652ha (5%) - tokë jopjellore apo djerrinë si dhe 15,074ha (42%) -pyje. Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, 12,666 ha është tokë e punueshme, 1652 ha të pa kultivuara dhe 2250 ha livadhe dhe kullosa. Kjo tokë është e mbjellë me kulturat bujqësore si drithëra, vreshta, perime dhe pemë. për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës gjatë viteve 2017 janë 4481ha të mbjella me drithëra, 949 ha me hardhi të rrushit, 646 ha të kultivuar me perime dhe 279 ha me pemë. Toka tjetër përbën 2250 ha me livadhe, 2010 ha të shndërru ar në kullosa dhe 2300 ha

Perimkultura

Është mjaft e përhapur në Komunën e Suharekës. Gjatë vitit 2017 janë ha me perime, ku si kulturë kryesore është domatja, speci, patatja, shalqiri, pjepri, qepa, etj. Viteve të fundit mbjellë 531 marr hov kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur (sera), ku sipas shënimeve të fundit janë mbjellë 27 ha.

Vreshtaria

Komuna e Suharekës është e njohur për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe prodhimtarinë e rrushit dhe verës. Sipas të dhënave nga "Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë" deri në fund të vitin 2018 në prodhimtari kanë qenë 513.84 ha vreshta që i përkasin sektorit privat, të mbjella në 2589 parcela të veçanta. Për shkak të politikave subvencionuese qeveritare dhe granteve të ndryshme ndërkombëtare kërkesat e fermerëve janë në rritje e sipër për kultivimin e kulturës së hardhisë së rrushit.

Pemëtaria

Komuna e Suharekës ka kushte të volitshme klimatike—tokësore shumë të favorshme për kultivimin e pemëve. Më së shumti kultivohen mollët, dardhat, kumbullat, qershizat, pjeshkat, kajsitë, arrat dhe gështenjat. Kjo veprimtari ka filluar të ringjallet, momentalisht me pemë janë të mbjella mbi 50 hektarë. Sipas të dhënave të drejtoratit për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari viteve të fundit sidomos nga 2012 e deri e deri me 2017 janë mbjell mbi 30 hektar me kultura të mollës, gjithë ashtu me tendencë të rritjes të këtyre sipërfaqeve. Në ekonominë familjare ngritja e kopshteve me pemë ka marr hov shumë të madh dhe sot kemi të ngritura 250 ha me lloje të ndryshme të pemëve në oborre dhe kopshte të shtëpive.

Shpeztaria

Mbajtja e shpendëve është mjaft e përhapur në ekonominë familjare. Gati çdo familje posedon një sasi të vogël të shpendëve, që kryesisht shfrytëzohen për nevojat familjare. mbas lufte kanë qenë 4 mini ferma për mbajtje të shpezëve (me kapacitet 3000-4000 krerë). Sipas të dhënave të fundit (janar 2018) nga numri i përgjithshëm i fermave të pulave vojsë është 7

ferma me kapacitet prej 2000-28000, pula vojse. Fondi i shpezëve është 39700 copë pula vojse.

Blegtoria

Sipërfaqja poseduese e livadheve, terreni i përshtatshëm për kullosa si dhe interesimi i vazhdueshëm i fermerëve për blegtorinë dhe shpezërinë janë potenciale të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe zbutjen e problemeve sociale në fshatra. Para luftës fondi i bagëtive ka qenë i pasur me gjedh (rreth 15,234 krerë). Gjatë luftës ky fond u përgjysmua dhe kap shifrën prej 7943 krerë lope qumështore

Turizmi

Pejsazhi i bukur në tërë komunën është bazë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm turizëm ekologjik. Në këtë rast qyteti po ashtu të koncentruar në ka potencialet e tij natyrore dhe pejsazhore të cilat i japin bazën që turizmi të filloi që nga aty, si një ambient që në të njëjtën kohë shndërrohet në pikë fokale informative dhe akomoduese për aktivitetet turistike që lidhen me qytetin dhe resurset e tij e po ashtu si pikë kohezive e të gjitha aktiviteteve turistike që ndodhin jashtë territorit urban. Komuna e Suharekës, bazuar në pasuritë natyrore dhe ambiente atraktive për adhuruesit e natyrës ka zona mjaft të përshtatshme dhe interesante për zhvillimin e turizmit që ndodhen në kompleksin e masivit të malit Sharr, i cili shtrihet në pjesën Verilindore dhe Juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e Maleve të Carralevës.

Bukuritë natyrore, vegjetacioni i pasur bimor, ujqor dhe lartësia mbidetare 1500m–2400m, klima mesdhetare alpine, zgjojnë kërshërinë e vizitorëve si gjatë verës ashtu edhe gjatë dimrit. Vende interesante të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike për t'u vizituar: Kalaja e Kastercit, Lokaliteti arkeologjik parahistorik në Shirokë dhe Reshtan, Kulla e Pashës në Mushtisht, Shtëpia e Ramë Bllacës në Bllacë, Kulla e Jonuz Tafollit në Qadrak, mullinjtë e Breshancit, mulliri i Dragaqinës, mulliri i Budakovës, mulliri i Semetishtit, mali i Sharrit, guri i Dellocit, Buqalla në Reqan, Xhami e Gazi Mehmet Pashës në Leshan, Xhamia e Bardhë në Suharekë, Muzeu në Suharekë. Ndërkaq nga historia më re e Kosovës ka përmendore dhe lapidare individuale ose kolektive të dëshmorëve, Kompleksi Memorial Parku i Dëshmorëve, përmendorja e viktimave civile të luftës në Suharekë dhe Kompleksi Memorial i viktimave të familjes Berisha në Suharekë.

Institucionet publike

Të jepen të dhënat për institucionet publike dhe private me theks të veçantë arsimin, shëndetësinë dhe institucionet tjera publike.

Shërbimet e administratës publike nga komuna e Suharekës ofrohen përmes ndërtesës kryesore komunale në Suharekë dhe 7 bashkësive lokale rurale Suharekë, Mushtisht, Studençan, Duhël, Gjinoc, Nishor, Bukosh, Mohlan dhe, të cilat ofrojnë distanca të shkurta nga vendbanimet të cilat i shërbejnë.

Institucionet arsimore

Në nivel komunal, procesi arsimor zhvillohet në tri nivele, arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Sistemi Edukativ e Arsimor në Komunën tonë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (SNKA): a) Niveli 0: Arsimi parashkollor (moshat 3 deri në 6 vjet). b) Niveli 1: Arsimi fillor (faza e parë e arsimit bazë) për 5 vjet (moshat 6 deri në 12 vjeç). c) Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit bazë) për 4 vjet (moshat 12 deri në 15 vjeç); dhe d) Niveli

3: Arsimi i mesëm i lartë për 3 ose 4 vjet, varësisht nga programet arsimore të përcaktuara nga MASHT (normalisht moshat 15 deri në 19 vjet). Rrjeti i ndërtesave të arsimit përbëhet prej 29 shkollave për Arsimi Fillor dhe të Mesëm i Ultë dhe në 3 shkolla të Arsimit të Mesëm të Lartë, ku përfshihen 11,522 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar rreth 1000 të punësuar, prej tyre 786 mësimdhënës dhe 38 edukatorë si dhe stafi udhëheqës, administrativ dhe mbështetës teknik.

Institucionet shëndetësore

Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Suharekës është i organizuar në tri nivele, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Suharekë, qendra të mjekësisë familjare 6 njësi në Mushtisht, Studenqan, Gjinoc, Duhël, Mohlan dhe Bukosh si dhe ambulanca 5 njësi në Grejkoc, Samadraxhë, Sopi, Nishor dhe Dobërdolan. Sipërfaqet e ndërtesave shëndetësore dallojnë në varësi të nivelit të shërbimit. Sipërfaqet e ambulancave sillen prej 95 deri 140 m² ndërsa sipërfaqet e QMF prej 205 deri në 325m². QKMF në Suharekë ka rreth 2270 m², sipërfaqe kjo e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e pacientëve që gravitojnë në këtë qendër.

Dokumentet relevante komunale

Planet e mëposhtme duhet të përshkruhen për qfarë periudhe janë dhe a përmbajnë ndonjë element sa i përket MM.

- Plani i zhvillimit komunal

Plani Zhvillimor i Komunës së Suharekës “Suhareka mjedis për të ardhmen”, në kuadër të prioriteteve kryesore e ka edhe prioritetin: Mbrojtja e variabilitetit natyrorë, që mundë të ndërlihet edhe me sektorin e menaxhimit e mbeturinave, ndërsa që në kuadër të katër shtyllave zhvillimore në shtyllën e Turizmit, janë si prioritete edhe mbrojtja e peizazhit dhe ambientit.

- Harta zonale

Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës (HZK) - përveç përmbushjes së kërkesës ligjore, t’i ofrojë qeverisjes komunale një instrument për kontroll të zhvillimit. HZK është dokument multi-sektorial me karakter rregullues, përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të komunës së Suharekës në zona (të tilla si hapësirat e lira, banim, industri, bujqësia, aktivitete ekonomike, etj.), ku për secilën zonë përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit si dhe masat e veprimit për periudhën së paku 8 vjeçare.

- Plani i emergjencave

Qëllimi i këtij Plani, është krijimi i prioriteteve për një kordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe profesionalisht, në raste të fatkeqësive. Ky dokument bazë, gradualisht është bërë detyrë kryesore, në procesin e zhvillimit dhe ndërtimit të mbrojtjes dhe të shpëtimit në Komunën e Suharekës, i cili do të përmirësoi dhe përshpëtoi implementimin e Ligjit për Fatëkeqësitë Natyrore dhe Fatëkeqësitë Tjera, për mbrojtjen të njerëzve, të mirave materiale dhe pronës nga fatkeqësitë natyrore në territorin Komunës së Suharekës dhe për të përmirësuar zbatimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji mbi Fatëkeqësitë Natyrore dhe Fatëkeqësitë Tjera, për të përcaktuar drejtimet për zhvillimin e mbrojtjes dhe operacionet e shpëtimit nëpërmjet zbatimit të planeve dhe projekteve konkrete në këtë fushë, koordinimin dhe funksionimin e

sistemit të mbrojtjes dhe të shpëtimit të Komunës së Suharekës, sidomos kur është fjala për zbatimin optimal të mbrojtjes dhe parandalimit dhe arritjen e gatishmërisë optimale e të gjithë bartësëve të mbrojtjes dhe të shpëtimit për të marrë masa operative në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave

2.1.1 Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të raporteve nga komuna dhe operatori për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale KRM “Ekoregjioni” Sh. A. njesia operative në Suharekë janë nxjerr të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbeturinave komunale gjatë vitit 2021. Duhet të cekim se nuk janë bërë analiza për kompozicionin të mbeturinave në nivel të komunës. Bazuar në raportin e komunës dhe operatorit, prej sasisë totale 15181 tonë të mbeturinave të grumbulluara nga 8740 ekonomi familjare të shërbyera që është vlerësuar në 56366 banorë, rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori në komunën e Suharekës për vitin 2021 të jetë 265 kg/banor/vit.

Tabela 3: Bilanci i mbeturinave komunale				
Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara nga operatorët	Mbeturinat e tregtuara / ricikluara	Mbeturinat e deponuara
Mbeturina mikse komunale	Peshim	15 181	-	15 181
Total:				

2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Në komunën e Suharekës aktualisht në kuadër të KRM Ekoregjioni SH.A.- Prizren, shërbimin për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave komunale e kryen njësia operative në Suharekë.

Tabela 4: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale					
	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhuar e mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	Krm Ekoregjioni Sh.A	Ndermarrje Publike Lokale – Regjionale		95.6 %	

Tabela 5: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e mbeturinave të menaxhuara	Sasia e mbeturinave të menaxhuara
Operatori 1	NA			

Mbulimi me shërbim:

Shërbimi themelor që komuna dhe operatori aktualisht e ofrojnë për qytetarët sa i përket mbeturinave komunale, është mbledhja, transporti dhe deponimi përfundimtar në deponin regjionale të Prizrenit në Landovicë.

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2021 në komunën e Suharekës ka arritur në 95.6 %.

Tabela 6: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës

Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
Ekoregjioni	8740	12109	850	788	72	60

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Ofrimi i shërbimit publik për mbledhjen e mbeturinave në komunën e Suharekes është i organizuar në tërë territorin e komunës duke përfshirë qytetin dhe vendbanimet rurale. Shërbimi në qytet kryhet qdo ditë, ndërsa në vendbanimet rurale një ditë brenda javës dhe sipas kërkesës nga komuniteti ky shërbim kryhet edhe më shpeshë dy here gjatë javës.

Tabela 8: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra ²	30%	7/ javë	70%	7/ javë
Zona rurale	100%	1/ javë	Nuk ka	1/ javë

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Në tabelën në vijim janë listuar asetet që janë në përdorim në Komunën e Suharekës.

Tabela 9: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave

Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l				
Shporta 240 l				
Kontejnerë 1.1 m3 metalik	182		70	112
Kontejnerë 1.1 m3 plastikë	-			
Kontejnerë 5.1 m3	18		15	3
Kontejnerë 7.1 m3	21		17	4
Kontejnerë 30 m3 - Transfer				

Ndërsa në tabelën nr.10 është shënuar numri dhe lloji i kamionëve të cilët bëjnë mbledhjen e mbeturinave në komunën e Suharekës.

Tabela 10: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m3	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja (e mirë /funktionale/e keqe)
Kamion	Isuzu	5.8	2012	01-742-FR	E mire
Kamion	Hino	8.88	2020	04Z-18-24	E mire

² Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

Kamion	Hino	8.88	2020	04Z-03-24	E mire
Kamion	Hino	8.88	2020	04Z-28-24	E mire
Kamion	Hino	8.88	2020	04Z-29-24	E mire
Kamion	Mercedes	4.62	2021	04Z-31-24	E mire
Kamion	Mercedes	4.62	2021	04Z-32-24	E mire
Kamion	Mercedes	14.6	2004	04-208-GH	E keqe
Kamion	Iveco	7.0	2001	04-174-CC	E keqe
Kamion	Mitsubish	4.00	2009	04-204-DI	E keqe
Kamion	Man	7.0	1989	04-852-HF	E keqe
Traktor	Ferguson	2.5	1999	424-KS-162	Funksionale
Kamionet	Mercedes	2.14	2012	04-416-IM	Funksionale

2.3 Rishikimi i implementimit të planit

Komuna e Suharekës në planin e menaxhimit të mbeturinave, ka pasur 7 objektiva kryesorë si: hartimi i kuadrit ligjor për MM, konsolidimi i shërbimit, nxitja e iniciativave për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, rritja e nivelit të arkëtimit, mbledhja e ndarë e mbeturinave në fraksione të caktuara, si dhe eliminimi i deponive ilegale.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin objektiv. Në përgjithësi rezultatet e realizimit të caqeve janë modeste për shkak të mungesave infrastrukturore dhe kapaciteteve institucionale. Poashtu vlen të ceket se edhe disa objektiva të planit nuk kanë qenë realiste dhe disa tjerë jo dhe gjithaq relevante.

Sido që të jetë ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në mospërmbushjen e objektivave.

Tabela 11: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual

	Objektiva e MM	Aktivitetet	Indikatoret e suksesit	Ndikimi i pritshëm	Realizimi %	Koment
1.	Riorganizimi institucional për menaxhim me mbeturina	Formimi i strukturës organizative dhe përshkrimi i vendeve të punës Planifikimi buxhetor Angazhimi i stafit	Numri i zyrtarëve të angazhuar në fushën e mbeturinave në Komunën e Suharekës	Forcimi institucional për menaxhimin e mbeturinave	50 %	Është e nevojshme që të krijohet njësi apo sektor për menaxhim të mbeturinave
2.	Përmirësimi i kornizës rregullative për menaxhimin e mbeturinave	Përgatitja e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave dhe miratimi i tyre Përgatitja e rregulloreve për tarifa për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave dhe miratimi i saj	Numri i rregulloreve të miratura	Përmirësimi i procedurave dhe rregullave për menaxhimin e mbeturinave	70 %	Duhet të rishikohet rregullorja për mbeturina
3.	Vendosja e sistemit të tarifave dhe i inkasimit të mjeteve	Përcaktimi i modelit të tarifimit Planifikimi buxhetor Përcaktimi dhe rishikimi taksës dhe tarifave të shërbimit Instalimi i sistemit softuerik për tarifa Implementimi i inkasimit të taksës dhe tarifës mbi mbeturina	Rritja e % në inkasimin e te hyrave për mbeturina	Përmirësimi i pagesave për shërbimet e mbeturinave	0 %	Nga komuna duhet të krijohet sistemi për faturin dhe inkasim
4.	Përmirësimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave	Analiza e nevojave dhe e efikasitetit të kompanisë (kompanive) për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave sipas zonave	Rritja e mbulushmërisë së zonave me shërbim për grumbullimin e mbeturinave dhe grumbullimi më efikas i mbeturinave	Numri vendbanimeve (% e territorit) të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	90 %	

5.	Rritja e riciklimit dhe kompostimit të mbeturinave	Përcaktimi i zonave dhe institucioneve për shpërndarjen e kompostereve dhe shportave për ndarjen e mbeturinave Blerja dhe shpërndarja e komposterëve Blerja dhe shpërndarja e shportave për ndarjen e mbeturinave	Numri i kompostereve të shpërndarë Numri i shportave për ndarjen e mbeturinave Numri i institucioneve të përfshira në sistemin e ndarjes së mbeturinave	Rritja e sasisë së mbeturinave të ricikluara dhe të kompostuara Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi Rritja e vetëdijesimit për riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave	10 %	
6.	Eliminimi i deponive ilegale ekzistuese	Plani operative për eliminimin e deponive ilegale Zbatimi i planit operativ për eliminimin e deponive ilegale	Numri i deponive ilegale të mbeturinave të eliminuara Sasia e mbeturinave të larguara nga deponitë ilegale	Reduktimi i deponive ilegale të mbeturinave Reduktimi i sasisë së mbeturinave të hedhura në sipërfaqe publike	70 %	
7	Vetëdijesimi dhe edukimit për menaxhimin e mbeturinave	Planifikimi i aktiviteteve edukative ne shkolla Zbatimi i aktiviteteve edukative ne shkolla Planifikimi i aktiviteteve me amvisëritë dhe bizneset Zbatimi i aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuere me biznese dhe amvisëri	Komuna e Suharekës Drejtorja e Shërbimeve Publike Dretjtoria e Arsimit, Zyra e informimit	Numri i shkollave të përfshira në aktivitete Numri i amvisërive dhe bizneseve të përfshira në aktivitete Numri i broshurave të shpërndara Numri i informatave	30 %	Vetëdijesimi dhe edukimit për menaxhimin e mbeturinave duhet të zhvillohet në vazhdimësi

2.4 Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Në tabelën në vijim është paraqitur stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve për MM në komunën e Suharekës, duke përfshi stafin direkt të angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të KRM Ekoregjioni, njësia operative në Suharekë, e cila ofron shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve përfshin stafin direkt e angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Numri i stafit total është 66 dhe raporti staf direkt staf administrative është 62% / 38%. Në përgjithësi efikasiteti i stafit të Ekoregjioni në komunën e Suharekës është më i favorshëm se në komunat tjera edhe pse stafi i operatorit është i angazhuar vetëm në grumbullimin e mbeturinave mikse dhe jo në ndonjë aktivitet të ndarjes dhe riciklimit.

Tabela 12: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM	
Kategoria	Numri i stafit
Stafi direkt	41
Kryepunëtorë	3
Shoferë	10
Punëtorë	28
Total staf direkt:	
Staf indirekt dhe administrative	
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë ³	3
Zyrtarë të rangut të mesëm	3
Staf teknik	
Zyrtarë të rangut fillestar	15
Staf tjetër	3
Total staf indirekt dhe administrative:	25
Total staf të MM	66
Mbeturina të grumbulluara	15 181 ton
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	4,35
EF të shërbyera	12 109
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	5.4

³ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Performanca e asetëve të grumbullimit dhe transportit:

Konsumi i naftës mesata është 4,8 l/ton dhe i njëjti është për një nuancë i lartë edhe pse komuna e Suharekës është komunë rurale dhe deponia e Ladovicës është larg gje që ndikon në harxhime. Në këtë joefikasitet ka ndikuar mungesa e planit të detajuar operativ si dhe prezenca e makinerisë së vjetëruar e cila nuk është efikase.

Tabela 13: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	
Kategoria	Performanca
Kamionët në operim	7
Kapaciteti maksimal operues (ton)	50
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	KMDK 14372.9 +Deponi private 808.64 = 15181.54 ton
Xhiro (xhiro/vit)	
Kilometrazhi (km/vit)	15898
Konsumi i naftës (l/vit)	73,046 liter
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	
Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve	
Konsumi i naftës l/100km	4.81
Konsumi i naftës l/ton	4.59

2.5 Performanca financiare e MM

2.5.1 Shpenzimet e shërbimit të MM

Struktura e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve shpalos faktin se shumica dërmuese e shpenzimeve shkojnë në paga dhe shpenzime administrative ndërsa amortizimi është shumë i vogël për shkak të asetëve të vjetëruara. Operatori duhet të përmirësoj efikasitetin e operimit për të siguruar fonde shtesë për investime të ripërtëritjes kapitale.

Tabela 14. Shpenzimet e shërbimit të MM		
Kategoria e kostove dhe shpenzimeve	Kostot (€/vjet)	Pjesëmarrja %
Shpenzimet e pagave	348,390.66	62,7%
Shpenzimet e materialit direkt ⁴	171,239.39	30,8%
Shpenzimet indirekte dhe administrative	36,271.65	6,5%
Amortizimi		
Total:	555,901.70	100%

2.5.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat në tabelën në vijim iu referohen të hyrave operative primare dhe sekondare. Amvisëritë janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave 67,9% e pasuar nga bizneset 13,9% dhe institucionet 3,7%. Shkalla e arkëtimit është 100% për shkak të arkëtimit të borxheve të vjetra ndërsa për amvisëri ajo është 97,9%.

⁴ Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

Tabela 15: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat operative	Të hyrat		Arkëtimi	
	€/vjet	%	€/vjet	%
-Amvisëritë	467,206.99	67,9%	457,245.77	97,9%
-Bizneset	95,884.19	13,9%	99,433.55	103,7%
-Institucionet	25,456.08	3,7%	27,067.32	106,3%
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	99,969.16	14,5%	107,966.70	108,0%
Total:	688,516.42	100%	691,713.34	100,5%

2.5.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Në tabelën në vijim është paraqit krahasimi i kostove dhe të hyrave si dhe kalkulimi i treguesve përfundimtar të performancës. Komuna e Suharekës i mbulon kostot porse kjo bëhet në kurriz të investimeve çka nuk paraqet stabilitet në periudhën afatmesme dhe afatgjate.

Tabela 16: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Kostot e MM	555901.70
Të hyrat e MM	688,516.43
Arkëtimi	691,713.34
Shkalla e mbulimit nga faturim i%	
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	100.39%
Kosto për ton të mbeturinave	36.62

2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Komuna e Suharekës nuk ka qender për ndarje dhe klasifikim dhe as Stacion transfer, mirëpo drejtpërdrejt mbeturinat e mbledhura i dergon në deponin regjionale të Prizrenit në Landovicë

Deponia

Komuna e Suharekës përmes vendimin të kuvendit komunal ka caktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave nga ndërtim - demolimi. Deponia e mbeturinave ndodhet në Shirok, në të cilën aktualisht hedhen pa ndonje trajtim paraprak. Në kuadër të zhvillimit të projekti me JICA në mbështetje të komunës së Suharekës, projekti për Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndetshme, faza 2 është duke u punuar në funksionalizimin e qendres për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave të KD.

2.7 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Jep të dhënat esenciale se si menaxhohen kategoritë e mëposhtme të mbeturinave:

- Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme

Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme në territorin e Komunës së Suharekës realizohet për ekonomitë familjare të qytetit të Suharekës nga kompania KRM Ekoregjioni. Vlen të theksohet se në nivelin regional mungon lokacion për trajtimin e këtij lloji të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi:

Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi në tërë territorin e komunës është I pa mundur për shkak të distancave. Kjo lloj mbeturine që krijohet nga demolimi I objekteve etj dergohet në deponin e caktuar nga komuna në Shirok dhe e cila kryesisht është shfrytëzuar nga banoret e qytetit të Suharekës. Deponia në fjalë pothuajse është në mbyllje. Komuna është duke hulumtuar lokacion të ri për mbeturina të KD, e cila si qender do të shërbej për të gjithë qytetaret e komunës së Suharekës

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Sfidë për komunën e Suharekës mbetet menaxhimi i mbeturinave shtazore. Forma aktuale e trajtimit të mbeturinave shtazore nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, është përmes kontraktimit të një operatori i cili e bën propozjen dhe dezinfektimin e zones ku propozën kafshët e ngordhura. Mbeturinat tjera të kafshëve që krijohen nga therrtoret dhe ekonomit familjare në komunën e Suharekës, hudhen në kontejner bashkë me mbeturina komunale duke përfunduar në deponin regionale në Landovicë- Prizren. Kjo situatë do të vazhdoj derisa AVUK- të funksionalizoj impiantin për trajtim të këtyre mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave medicinal

Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga KRM Ekoregjioni dhe të njëjtat dergohen në impiantin për sterizim në Prizren, e cila ka kontratë me QKMF dhe AMF. Ndërsa mbledhja e mbeturinave mjekësore nga ordinancat private nuk ka të dhëna se si zhvillohet ky aktivitet.

- Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Për kategoritë tjera të mbeturinave që gjenerohen në komunën e Suharekës, siq janë bateritë, vajrat mbeturinë, mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, komuna nuk ka të dhëna për këto mbeturina. Ky lloj I mbeturinave kryesisht është I organizuar nga sektori privat të cilët bëjnë mbledhjen dhe grumbullimin e këtyre mbeturinave.

3 Objektivat e MM dhe plani operacional

3.1 Vizioni i MM

Komuna e Suharekës synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar më qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

3.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme (edhe pse lista nuk është e kufizuar):

Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Eliminimi i deponive ilegale
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Suharekës është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
1.1	Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /ditë)	Sasia e mbeturinave të grumbulluara për banor (kg /ditë)	-	-	-	-	-	-

1.2	Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara	Shërbimi është riorganizuar për të bërë matjen e mbeturinave në pikën e grumbullimit	-	-	1	-	-	-
1.3	Zbatimi i tarifave volumetrike	Tarifat volumetrike janë miratuar dhe po aplikohen	-	-	-	1	-	-
1.4	Futja e pakos stimuluese	Pako stimuluese është hartuar dhe miratuar	-	-	-	1	-	-
1.5	Shpërndarja e komposterëve individual	Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF dhe biznese „zero ëaste“	-	100	200	200	200	300
1.6	Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të gjenerimit të mbeturinave	Fushata informative po zbatohet	-	1	1	1	1	1

3.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin nevojitet:

- **Plani i riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT

Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike nevojiten aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes

- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifatat e bazuara në matje
- Zbatimi i tarifave PAYT

Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe “zero mbeturina”:

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bëjnë atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrojnë mundësi që të kryejnë furnizimet në këto dyqane.

Komunat mund të luajnë rolin e tyre që të i promovojnë këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do të ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifatat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante “zero mbeturina”:

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkëfinancim komposterë individual të cilët do të reduktojnë mbeturinat që do të hudhen në kontejnerët apo shportat që do të grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.

Komuna do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektive.

3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësive së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 2 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 19: Korniza strategjike e Objektivit 2								
Nr.	Masat / aktivitete / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
2.1	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave komunale	Analiz e gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar	-	-	1	-	-	1
2.2	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar	-	-	1	-	-	-
2.3	Zgjerimi i infrastrukturës ndarëse të mbeturinave në burim	% EF me ndarje në burim	0 %	5 %	10 %	20 %	30 %	40 %
2.4	Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	% e riciklimit të letres, kartonit, plastikes, metalit dhe qelqit	0 %	5 %	10 %	20 %	25 %	30 %
2.5	Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese	% e riciklimit të mbeturinave ushqimore dhe mbeturinave tjera biodegraduese	0 %	5 %	10 %	20 %	25 %	30 %
2.6	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio-degraduese	Operatori është kontraktuar			1			
2.7	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar				1		

2.8	Funksionalizimi i deponisë së MND	Procedurat administrative për funksionalizimin e deponisë janë zbatuar		1				
2.9	Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komune.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
2.10	Kontraktimi i operatorit privat për MND	Operatori është kontraktuar				1		
2.11	Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo degraduese	Operatori është kontraktuar			1			

Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (rritje / zbritje)		-	-	-	-	-
Qyteti (banorë)	10422	10422	10422	10422	10422	10422
Zona ruarë (rritje / zbritje)		-	-	-	-	-
Zona ruarë (banorë)	48456	48456	48456	48456	48456	48456
Total banorë	58878	59561	60251	60943	61858	62849

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave është dhënë në tabelat në vijim për komunën e Suharekës.

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata në zonën urbane	10422	10422	10422	10422	10422	10422
Gjenerimi për kokë banori ZU (kg/v)	265	265.76	265.80	265.85	265.82	265.85
Gjenerimi i mbeturinave ZU (kg/v)	2762	2770	2770	2771	2770	2771

Popullata në zonën rurale	48456	48456	48456	48456	48456	48456
Gjenerimi për kokë banori ZR (kg/v)	265	265.76	265.80	265.85	265.82	265.85
Gjenerimi i mbeturinave ZR (kg/v)	12878	12880	12882	12881	12882	12878
Gjenerimi vjetor i mbeturinave (kg/v)	15647	15650	15653	15651	15653	15647

Parashikimi i kompozicionit të mbeturinave të gjeneruara është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit nga komuna e Pejës.

Tabela 22: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit						
	Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
%	Letër dhe karton	19.15%	19.19%	19.22%	19.24%	19.26%
	Qelq	6.45%	6.46%	6.47%	6.48%	6.49%
	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.45%	34.53%	34.58%	34.62%	34.64%
	Tekstil dhe veshjet	5.85%	5.86%	5.87%	5.88%	5.88%
	Pllastika	19.45%	19.49%	19.52%	19.55%	19.56%
	Metal	1.05%	1.05%	1.05%	1.06%	1.06%
	Të tjera	13.60%	13.63%	13.65%	13.67%	13.68%
ton	Letër dhe karton	2 996	3 003	3 009	3 011	3 015
	Qelq	1 009	1 011	1 013	1 014	1 016
	Mbeturina bio-degraduese ⁵	5 390	5 404	5 413	5 418	5 422
	Tekstil dhe veshjet	915	917	919	920	920
	Pllastika	3 043	3 050	3 055	3 060	3 062
	Metal	164	164	164	166	166
	Të tjera	2 128	2 133	2 137	2 139	2 141

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës së Suahrekës, në raport me procesin e ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi, plastika dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

Tabela 23: Caqet e riciklimit					
Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Të riciklueshmet jo-degraduese %	5%	10%	15%	20%	25%
Të riciklueshmet jo-degraduese (ton)	361	723	1 086	1 450	1 815
Të riciklueshmet biodegraduese %	5 %	10 %	15 %	20 %	25 %
Të riciklueshmet biodegraduese (ton)	270	540	812	1 084	1 356

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komuna e Suahrekës do të zbatoj studimin e gjenerimit dhe kompozicionit si dhe një studim të fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit.

Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

⁵ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

- Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale:

Komuna e Suharekës është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale.

Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim:

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	95.6 %	100 %	100 %	100 %	100 %	100 %
Mbulimi me ndarje në burim	-	10 %	15 %	20 %	30 %	40 %

- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Suharekës do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikatat më të mira.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përçindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të tentoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimi i partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- zhvillimi i skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve sa i përket vajrave mbeturinë

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:

- Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Suharekës planifikon të hap **qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e kësaj qendre komuna do ta caktoj lokacionin për këtë qëllim.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët mund të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna duhet përmes një **studimi të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës (qendrave) të analizoj dhe të vendos se a ta menaxhoj këtë vetë këtë qendër apo ta angazhoj një operatorë privat.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna ka caktuar lokacionin e deponisë dhe me JICA është në proces të përgaditjes së procedurave për funksionalizim të kësaj qendre. Komuna pas përfundimit të procesit për dhënie në menaxhim të kësaj qendre/deponie do të udhëzoj personat fizik dhe juridik që ti dërgoj mbeturinat në këtë lokacion i cili do të operohet nga kontraktori i licencuar i cili poashtu do të kontraktohet nga komuna siq e parasheh ligji.

Komuna do të instaloj një sistem i cili në kuadër të lejes ndërtimore do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen. Lokacioni ku do të dërgohen mbeturinat e KD është caktuar nga komuna në Shirok. Poashtu inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do të dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbehen nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna do të zbatoj një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit.**

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetsorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatoret publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

Menaxhimi i qendrushëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në Halilaq të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë asgjësimin përmes proqesit të groposjes dhe dezinfektimit dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet për trajtim.

Mishtoret, therrëtoret dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do të hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

Aktivitet vetëdijësues për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqarohet se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

3.5 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 33: Korniza strategjike e objektivit 3								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
3.1	Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	% e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	95.6 %	100 %	100 %	100 %	100 %	100 %
3.2	Plani i ri operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	Plani operativ është hartuar / reviduar dhe miratuar	-	1				
3.3	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është zbatuar	-	-	1	-	-	-
3.4	Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-	1	-	-	-
3.6	Zgjidhja e statusit të rasteve sociale	Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur	-	-	1	-	-	-

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

3.5.1.1 Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjeroj ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 26: Strategjia e zgjerimit me shërbim

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim	95.6 %	100 %	100 %	100 %	100 %	100 %

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Komuna do të hartoj **planin e ri operativ** i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultoj përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit:
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale:

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmer **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave të vëllimshme

Lidhur me grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme komuna fillimisht do të caktoj lokacionin dhe më pastaj të ndërtoj dhe funksionalizoj qendrën për grumbullim dhe ripërdorim të mbeturinave të vëllimshme. Komuna para funksionalizimit do të zbatoj **fushatë informuese** përmes së cilës do të informoj qytetarët për këtë qendër, llojin e mbeturinave të cilat mundën të dërgohen në këtë qendër, orarin e punës, etj.

Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të koston

Komuna ka përcaktuar si objektivi përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të koston në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e rekrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 27: Efikasiteti i stafit						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt		-	-	-	-	-
Stafi indirekt dhe administrativ		-	-	-	-	-
Amvisëritë e shërbyera		-	-	-	-	-
Konsumatorët e shërbyer		-	-	-	-	-
Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer		-	-	-	-	-

Ideja është që stafi administrativ të zvogëlohet karshi stafit direkt

Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer	7.4	-	-	-	-	-
--	-----	---	---	---	---	---

Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Revidimi i planit operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Përforcimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qendrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qendrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos

Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna

3.6 Objektivi nr. 4: Eliminimi i deponive ilegale

Ky objektivi referohet gjendjes aktuale në teren, ku për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave. Me qëllim të sanimit të gjendjes, komuna e Podujevës do të angazhohet që për çdo vitë të organizoj pastrimin e këtyre lokacioneve të ndotura me mbeturina dhe vendosjen e shenjave informuese dhe ndërgjegjësuese joftuese për mos hudhjen e mbeturinave.

Tabela 28: Korniza strategjike e objektivit 4								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
4.1	Pastrimi i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave	Pastrimi është realizuar	-	1	1	1	1	1
4.2	Fushatë informuese	Deponite ilegale reduktohen vazhdimisht	-	1	1	1	1	1
4.3	Inspektim dhe monitorim	Shqiptimi i gjobave		1	1	1	1	1

3.7 Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Tabela 29: Korniza strategjike e objektivit 5								
Nr.	Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
5.1	Revidimi i RrK të MM	RrK e MM është reviduar	-	-	1	-	-	-
5.2	Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Sektori është formuar	1	-	-	-	-	-
5.3	Kalimi i procesit tariforë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
5.4	Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
5.5	Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët	Programi zbatohet	-	-	1	-	-	-

- Hartimi dhe miratimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave

Komuna këtë obligim është duke e kryer gjatë vitit 2022. Plani parashihet të përfundohet deri në fund të vitit 2022 dhe drafti do të paraqitet për miratim asamblesë komunale për miratim sipas procedurave në fuqi. Komuna planifikon që ta miratoj planin gjatë vitit 2022 dhe plani do të zgjas deri në vitin 2027 ku komuna parasheh ti nënshtrohet procesit të revdimin siq parashihet me ligj.

- Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave

Komuna e ka miratuar rregulloren komunale të MM, por parasheh qe te njëjtën ta revidoj gjatë vitit 2024 për të përditësuar ndryshimet që dalin nga amendimet ligjore.

- Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

- Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

- Kalimi i procesit tariforë

Komuna e ka kaluar procesin tariforë dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2024 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

- **Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët**

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

4 Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme, andaj komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente.

5 Plani financiar, veprimet dhe i monitorimit

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuara përmes buxhetit të komunës, bashkëfinancimit me komunat tjera apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

Tabela 38: Plani financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektiv 1 „Parandalimi dhe reduktimi“								
Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Riorganizimi i shërbimit				60,000 €			60,000 €	
○ Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP			10,000 €			10,000 €	Komuna
○ Sigurimi i infrastrukturës matëse	DSHP			50,000 €			50,000 €	Donacion
Zbatimi i tarifave volumetrike			10,000 €				10,000 €	
○ Kalimi i tarifave PAYT (procesi)	DSHP		2,500 €				2,500 €	Komuna
○ Azhurnimi i softuerit të faturimit	DSHP		7,500 €				7,500 €	Komuna
○ Zbatimi i tarifave PAYT	KRM			x				KRM
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset				2,500 €			2,500 €	
○ Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal	DSHP			2,500 €			2,500 €	Komuna
○ Pakoja e lehtësimeve fiskale	DSHP			x				Komuna
Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante ⁶	DSHP	12,000 €	24,000 €	24,000 €	24,000 €	36,000 €	120,000 €	50% Komuna; 50% Donacion
Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit		700 €	700 €	700 €	700 €	700 €	3,500 €	Komuna
○ Fushata e vetëdijësimit	DSHP	700 €	700 €	700 €	700 €	700 €	3,500 €	Komuna
Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave		12,700 €	34,700 €	87,200 €	24,700 €	36,700 €	186,000 €	

⁶ Furnizimi me komposterë: Vitet 2023 100, 2024 - 2026 nga 200 dhe viti 2027 300 komposterë.

Tabela 39: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale		5,000 €	5,000 €	110,000 €	5,000 €	5,000 €	130,000 €	
○ Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP			25,000 €			25,000 €	Komuna
○ Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna
○ Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
○ Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP			75,000 €			75,000 €	Donatori
○ Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra	DSHP	x	x	x	x	x		
○ Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit	DSHP							Komuna
Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale		15,000 €	75,000 €				90,000 €	
○ Studimi i fizibilitetit	DSHP	15,000 €					15,000 €	Komuna
○ Ndërtimi i qendrës së grumbullimit/ripërdorimit ⁷	DSHP		75,000 €				75,000 €	Komuna / donatori
○ Funksionalizimi i qendrës	DSHP			x				Komuna
Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi			28,000 €	150,000 €			178,000 €	
○ Caktimi i lokacionit	DSHP							
○ Kontraktimi i operatorit	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
○ Caktimi i tarifave	DSHP		3,000 €				3,000 €	Komuna
○ Studimi i fizibilitetit			20,000 €				20,000	

⁷ Për komunën e Suharekës parashihet ndërtimi i një qendre të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

o Rehabilitimi i qendrës së MND ⁸	DSHP			150,000 €			150,000 €	Komuna / donatori
o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP					x		Komuna
Menaxhimi i mbeturinave shtazore								
o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat		x	x					
o Inspektimi i zbatimit		x	x	x	x	x		
Menaxhimi i mbeturinave medicinale								
o Inspektimi i zbatimit		x	x	x	x	x		
Fushatat e vetëdijësimit		700 €	700 €	700 €	700 €	700 €	3,500 €	Komuna
Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi		20,700 €	163,700 €	330,700 €	5,700 €	5,700 €	406,500 €	

Tabela 32: Plani financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		47,500 €	263,500 €	198,500 €	23,500 €	23,500 €	556,500 €	
o Përditësimi i planit operativ	DSHP	25,000 €					25,000 €	Komuna
o Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit	DSHP		100,000 €				100,000 €	Donator
o Furnizimi me shporta 120 l	DSHP						€	Donator
o Furnizimi me shporta 240 l	DSHP						€	Donator
o Furnizimi me shporta të rrugëve	DSHP		1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	4,000 €	KRM
o Furnizimi me kontejnerë metalik 1.1 m ³ ⁹	DSHP	22,500 €	22,500 €	22,500 €	22,500 €	22,500 €	112,500 €	Donator
o Furnizimi me kamionë 10t	KRM			175,000 €			175,000 €	Donator
o Furnizim me autocisternw	KRM		100,000 €				100,000 €	Donator
o Furnizim me autofshesa	KRM		40,000 €				40,000 €	Donator Komunw
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare		- €	20,00 €	- €	- €	- €	20,000 €	
o Marrja përsipër e faturimit nga komuna	DSHP/KRM			x				Komuna

⁸ Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

⁹ Çdo vit nga 50 kontejnerë 1.1 m³

○ Zhvillimi i softuerit të faturimit	DSHP/KRM		20,000 €				20,000 €	Komuna
○ Monitorimi i performancës	DSHP/KRM	x	x	x	x	x		Komuna
Kampanja informative	OJU	750 €	750 €	750 €	750 €	750 €	3,500 €	Komuna
Total objektiva 3 - Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qendrueshme		48,250 €	284,250 €	199,250 €	24,250 €	24,250 €	580,250 €	

Tabela 33: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjete i fundit“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Caktimi i tarifave të shërbimit të deponimit	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Eliminimi i deponive ilegale	DSHP	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	15,000 €	Komuna
Inspektimi dhe masat detyruese	Inspektorati	x	x	x	x	x		Komuna
Total objektiva 4 – Deponimi i sigurtë si mjete i fundit		3,000 €	8,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	20,000 €	

Tabela 34: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Revidimi i RrK të MM	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitetit	DSHP							Komuna
Kalimi i procesit tariforë	DSHP			3,500 €			3,500 €	Komuna
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	75,000 €	Komuna
Hartimi i planit të menaxhimit të shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente si pjesë e planit të emergjencave të komunes.			3,000 €				3,000 €	
Total objektiva 5 – Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale		15,000 €	23,000 €	23,500 €	15,000 €	15,000 €	91,500 €	

